

## Procesverbal

*Nga Mbledhja VIII (e tetë) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë: 30.08.2024*

### *Rend Dite*

1. Miratimi i procesverbaleve nga seancat VI dhe VII;
2. Miratimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave; dhe
3. Eventuale.

**Arijeta Skeraj:** Përshëndetje kryetar, përshëndetje të gjithë anëtarëve të Kuvendit, përshëndetje media, përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Mirë se keni ardhë në seancën e tetë të rregullt për vitin 2024 të Kuvendit të Komunës së Dragashit! Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë. Para se ta qesim në votim rendin e ditës, nëse ka dikush që ta marrë fjalën?

**Nexhat Selaj:** Faleminderit, kryesuese! Përshëndetje kryetar, kolegë asambleistë dhe ju të pranishëm! Pasi që është fillimi i vitit shkollor kalendarik 2024/2025, përpos këtyre dy pikave dhe të tretës, eventuale që keni paraparë, unë si asambleistë, në kuadër të PDK-së, Dega në Dragash, propozojmë që në rend të ditës të kemi edhe një pikë: Fillimi i vitit shkollor kalendarik 2024/2025. Faleminderit!

**Nedžmidin Sejdlar:** Përshëndetje të gjithëve, kam ardhur në këtë foltore për të pyetur kryesuesen se a i përgatisni këto seanca dhe a vendosni se kur do të mbahet seanca e Kuvendit dhe me çfarë rend dite. Ose dikush ju përgaditën. Ju vetë thatë se kurrë nuk do të organizoni seanca të kuvendit të premtëve. Ju thatë se asnjëherë nuk do të organizoni seanca kuvendesh gjatë të premtëve. Më intereson pse.

**Uran Halimi:** Përshëndetje të nderum delegatë, media, qytetarë të Komunës sonë, si dhe të gjithë ju të pranishëm! Meqenëse po flasim për rendin e ditës, dua të ndërlihem me një çështje goxha të rëndësishme dhe të vlefshme. Pak më herët kam bërë kërkesë për qasje në dokumentacion zyrtar, edhe kam kërku që të më servohen të gjitha faturat për mirëmbajtjen e automjeteve të Komunës. Kjo edhe më granatohet me ligj, siç e dini, të nderuar delegatë. Më janë servuar faturat, edhe nga ajo që pashë, vetëm në periudhën prill-korrik 2024 mirëmbajtja e veturave të Komunës ka një kosto goxha të madhe, marramendëse me thënë. Është vlera diku 53 mijë e tetëqind e pesë...

**Arijeta Skeraj:** Uran, unë të kërkoj falje, veç a ke diçka për rendin e ditës?

**Uran Halimi:** Po po, për rendin e ditës, veç mos më ndërprej, të lutem! Domethënë e kap një kosto deri në 53,805 euro. Prej atyre, unë vërejtja që mirëmbajtja e xhipave na ka kushtuar goxha shtrenjtë. Ma herët, ish-drejtori i Administratës më ka thënë që i kam shumë qef xhipat, unë s'e disha pse i ka qef, po kur e bona këtë kërkesën për qasje në dokumentacion zyrtar, e pashë edhe e kuptova se pse i ka qef. Tjetra është që, te përshkrimi i automjeteve mu nuk më kanë dhënë asnjë detaj, as tabelat e regjistrimit e as kurgjo, vetëm i kanë dhënë detajet për karakteristikat e këtyre xhipave. Prej atyre faturave që unë munda me i përmend janë katër fatura që e kapin shifrën për secilën gati 2000 euro. Një hulumtim edhe një vërejtje që e pashë është se...

**Arijeta Skeraj:** Të kërkoj falje, Uran, cila është pika që duhesh me e bo si kërkesë këtu? Pastaj kemi në eventuale, tash jemi veç te rendi i ditës. Të kisha lut, në qoftë se ke diçka për rend të ditës!

**Uran Halimi:** Okej! E vërejtja që një veturë e tipit Ford, e vitit 2019, iu kongan ndërrue amortizatorët e pasëm. Unë e kam një veturë të 2001-tës edhe një të 2013-tës, që asnjëherë në jetë nuk ia kemi ndërrue amortizatorët. Gjithsesi, duke i vërejt këto fatura, mbase, sipas mendimit tem janë të dyshimta, ne duhet t'i vërtetojmë ato. Andaj, propozoj si pikë e rendit të ditës të jetë formimi i një komisioni i cili heton mirëmbajtjen e veturave të Komunës së Dragashit, domethënë mirëmbajtjen e të gjitha veturave, jo

vetëm të një dikasteri. Faleminderit shumë!

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit, a do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë i patëm dy propozime. Propozimi i parë ishte fillimi i vitit shkollor 2024/25 nga Nexhat Selaj, dhe propozimi i dytë ishte formimi i një komisioni për mirëmbajtjen e veturave. Po shkojmë veç e veç. Kush është pro që të shtohet pika për fillimin e vitit shkollor 2024/25? A ka kundër? Abstenim? Me 25 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, edhe kjo pikë hyn në rend të ditës. Pika që e propozoi Urani ishte formimi i një komisioni për hetimin e mirëmbajtjes së veturave. Kush është pro kësaj?

**Bexhet Xheladini:** E nderuar kryesuese, të nderuar delegatë, mjete të informimit, përfaqësues i OSBE-së! Kësaj seance të Kuvendit i dëshiroj suksese! Unë propozoj që të gjithë delegatët ta votojnë formimin e komisionit.

**Samidin Xheladini:** Të nderuar të pranishëm, ju përsëndes të gjithëve! Delegatët kanë të drejtë të propozojnë çka të duan. Ne duhet të punojmë me ligj. Nuk do të hy a na takon a s'na takon, se nuk është punë e jemja. Unë deshta pikërisht për formimin e komisionit. Ne kemi formuar edhe komisione tjera. Kryesues Uran Halimi, a e kemi krye detyrën na? Jo, në gjys e kemi lënë. Dyshoj që na prapë qata jemi, që e lëmë punën në gjys. Të lutem, ta kryejmë një herë qat punën që e kemi nis, edhe këtë e vazhdojmë, po dyshoj që ne s'kemi përgjegjësi, nuk jemi duke i kryer punët tona. Po më vjen keq, ne që dy vjet kemi formue komisione, e kemi lënë punën në gjys. Jam anëtar edhe unë. E ti je kryesues i Komisionit.

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit, z.Xheladini! Atëherë, kush është pro që të futet propozimi i Uran Halimit? A ka kundër? Abstenim? Me 26 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, edhe kjo pikë futet në rend të ditës. Atëherë, e qesim në votim rendin e ditës me këto dy propozime. Kush është pro rendit të ditës me këto dy pika që u shtuan? A ka kundër? Abstenim? Me 26 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës.

**Uran Halimi:** z.Xheladini, të falënderoj shumë për rikujtimin, por nuk e kam qit jashtë mendve. Komisioni për hetimin e pagave është Komision që ka afat edhe mandat deri në fund të kësaj qeverisjeje. Nuk e kam pas ndërmend që me e neglizhues, e sidomos kohën e fundit që kam bo material hala ma shumë. Prej shtatorit do ta vazhdojmë këtë Komision edhe do ta hetojmë së bashku secilën vërejtje që ti zakonisht ke hamendësue. Unë jam kryetar i Komisionit, në koordinim me ju kemi me takue prej shtatorit kismet, kemi me e përmbyllë shumë shpejt. Por, nuk do të ndalemi prapë, deri në fund të qeverisjes, edhe nëse ne e biem një raport për periudhën që ka kaluar deri më sot, ose kurdo që përfundon ky Komision, ne kemi mandat që deri në fund të qeverisjes besoj që kemi me u takue prapë. Kuvendi nuk na zgjat, se na e kemi mandatin me Kuvend. Kështu që, ka me vazhdue Komisioni kismet!

**Arijeta Skeraj:** Atëherë, fillojmë te pika e parë: Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet VI dhe VII. A do dikush me e marrë fjalën këtu? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 25 vota pro, 1 kundër dhe zero abstenim, i miratojmë procesverbalet nga mbledhjet VI dhe VII. Vazhdojmë te pika e dytë: Miratimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave.

**Shpetim Hajredini:** Përsëndetje të nderuar kolegë asambleistë, nënkryetar, drejtorë dhe ju të pranishëm, ju përsëndes të gjithëve! Për këtë Rregullore kena diskutue edhe në njërin ndër seancat e mëhershme, dhe në fund është kërkuar dhe kena votue që të shtyhet për në një seancë sa më të afërt. Sot e kemi këtë Rregullore e cila për ne është shumë e rëndësishme dhe natyrisht ne jemi për të mirën edhe për pastërtinë e këtij vendi. Për të pasur pastërti, natyrisht që duhet të ketë edhe rregullore. Nuk do të hyj të diskutoj shumë për të gjitha nenet, por natyrisht do të kaloj direkt tek nenet të cilat edhe është bërë ndryshimi dhe na ka ardhë materiali ditën e hënë, mos gabofsha. Pra, do të kalojmë tek faqja 11 dhe Neni 14.3 – Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguajë faturën e tarifës së mbeturinave për çdo muaj të vitit, si dhe me këste nga tremujore brenda vitit. Dhe ka qenë e ndarë, natyrisht – që ne në ekonomi e quajmë si TM1, TM2, TM3 dhe TM4. Janë janari deri në mars; prill-qershor; korrik-shtator dhe tetor-dhjetor. Me materialin e ri i cili na është sjellur pastaj nga ekzekutivi, kjo alternativë është fshirë, është larguar komplet, dhe është rikthyer në alternativën e pagesës vetëm mujore. Arsyen e këtij ndryshimi kërkoj që ta ma japë – normal, nëse e din kryetari, në rregull, nëse nuk e din atëherë

përfaqësuesi i cili ka njohuri në këtë drejtim, apo drejtori. 14.5-shi thotë kështu: Të gjithë familjarët që janë me asistencë sociale, si dhe të gjitha institucionet fetare lirohen nga pagesa e mbeturinave. Në materialin i cili na është sjellur të hënën, kush e ka lexuar e din që edhe ky nen është larguar. Pse ka ndodhur ky largim, prapë pres përgjigje. I nderuar kryetar, i nderuar drejtor, gjithashtu besoj se shumica prej asambleistëve i kanë lexuar edhe çmimet me të cilat janë ngarkuar qytetarët edhe bizneset, dhe të cilat kanë ndryshuar në krahasim me atë Rregulloren e mëhershme që e kena pasur. Dhe, me Rregulloren e materialit i cili na është dërguar herën e parë. Pra, të nderuar qytetarë, i nderuar ekzekutiv, tarifat e taksës për mbeturina, tarifat mujore - 5.50 njësi familjare/rezident; 4.50 individ; dhe 20 euro jorezident. Këtu është bërë edhe një lëshim, që besoj duhet të ndryshohet. Tarifa mujore, dy të parat duhet të mbesin si tarifa mujore, ndërsa tarifa tjetër, jorezident/mërgata 20 euro, duhet të ndryshohet dhe të shënohet tarifë vjetore. Nëse nuk jam gabim, se mërgata nuk duhet të paguajë 20 euro në muaj, por duhet ta ketë në vjet. Besoj se ashtu ka qenë, të shënohet dhe të ndahet, jo tarifë mujore, të mos mbetet, por të kalojë në atë vjetore të shënohet. Ka mundësi që ky lëshim nuk është bërë me qëllim – besoj – pasi që kuptohet që është tarifë vjetore për mërgatën, por natyrisht në material është dashtë të shënohet dhe të mos figurojë njëjtë në atë ndarjen si tarifat mujore që janë për familjet rezidente dhe individët. Duhet ta bëni këtë përmirësim dhe gjatë votimit më të mos figurojë. Tjetra, ju e dini që në seancën e kaluar, kur kemi diskutue për këtë Rregullore, kolega im Dritoni ka dhënë do ndryshime tek tarifat. Ato jo që nuk janë marrë parasysh tash në materialin e ri ato janë shtue, janë rrit edhe më tepër. Unë nuk po e di tash, ndoshta rrogat po na rriten, edhe po lidhet e po na rriten edhe shpenzimet. Por, besoj që nuk është e arsyeshme, qytetarët tanë mjaft janë të ngarkuar. Gjithashtu edhe bizneset, mjaft kanë ngarkesa. Ne jemi këtu për lehtësira, për t'ua lehtësuar gjendjen atyre dhe jo për t'ua ngushtuar dhe ngarkuar edhe më tej. I kisha dhënë edhe propozimet e mia unë, mirëpo këtë të drejtë nuk dua t'ia marr kolegës tim. Le të dalë ai dhe le ta japë propozimin e tij për ndryshimet e çmimeve, ndërsa unë do të vazhdoj tek pika e fundit që e kemi pas në materialin e parë, tek vërejtjet. Në materialin e ri nuk e kenë. Pra, ka qenë ndërtesat fetare të përjashtohen nga tarifa për largimin e mbeturinave, tanimë këto nuk largohen dhe do e bëjnë pagesën. Unë, e nderuar kryesuese, të nderuar kolegë asambleistë, propozimin të cilin e kam bërë në atë seancën e parë kur kemi diskutue për këtë Rregullore, prapë do ta bëj. Por, natyrisht që do t'a shtoj edhe ndërtesat fetare, që të vazhdojnë të jenë të lira nga tarifat. Gjithashtu, e kam thënë në atë seancë, që duhet të lirohen edhe familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe veteranëve. Nëse mendojmë që kjo shumë që do të participojnë këto familje, na krijon ndonjë hendek të madh financiar për kompaninë, atëherë ne jemi këtu, ne do ta votojmë buxhetin, edhe këtë hendek financiar mund ta bartim nga buxheti i Komunës edhe t'ua lehtësojmë qytetarëve, sado pak çka kemi mundësi ne të bëjmë për ta. Nuk është ndoshta, besoj, për një pjesë të familjeve shumë rritje e madhe, por për një pjesë të konsiderueshme të qytetarëve të Komunës sonë, është e mjaftueshme kjo rritje. Andaj, e nderuar kryesuese, ta kesh parasysh propozimin tim ta qesësh në votim. Unë jam i bindur që kolegët asambleistë e kanë parasysh propozimin tim dhe nuk besoj që është për të qenë kundër. Ne të gjithë jemi për të mirën e qytetarëve dhe të gjithë jemi për të mirën e bizneseve. Ne jemi këtu për t'i mbështetur bizneset dhe qytetarët. Prandaj, pres mbështetje dhe besoj që ky propozim i imi do të kalojë. Ju faleminderit!

**Driton Ademi:** Faleminderit, kryesuese! Përshëndetje për të gjithë! Atëherë, siç e tha kolegu Shpetim, për qeto pikat të cilat i foli, ndërtesat fetare. Unë e kam edhe një propozim tjetër. Ne i kemi edhe zyret e partisë të cilat – as nuk e dimë as vetë, pa pikë nënshkrimi – kur i kemi pa borxhet, si ju që jeni në pushtet, si na, nuk e dimë, kanë ardhë fatura qaq të fryme, që as kurrë nuk kam pa faturë. Kam pa faturë qe tri vjet, fatura ka ardhë marramendëse. A për sa vjet nuk kam pa faturë. Është mirë edhe këto objektet, pasi janë pjesë të Komunës, edhe këto objekte hapen një herë në katër vjet, një muaj ditë, është mirë me i lirue, ose me i shti si pjesa e mërgatës, që mos me i shti me pague, se nuk janë aktive këto zyre. Tash me i shti me i dhënë borxhe këtyre për një herë në katër vjet, një muaj ditë që mundim me punue, po më doket pak absurde. Nuk do të ju marr shumë kohë, do të kaloj te çmimet të cilat edhe vjet i kemi propozuar. Kryesuese, edhe një pyetje nëse ka mundësi, unë nuk jam t'u e ditë, me cilën

Rregullore sot jemi, a me Rregulloren e të martës apo të datës të cilën ka ardhë në fillim, para dhjetë ditë, a dy javë. Të dyjat kanë ndryshime shumë të mëdha, si në çmim, si... atëherë, unë po kaloj te propozimi i parë, te çmimet. 5.50/Njësi familjare rezident, unë nuk e shoh të arsyeshme me e rrit qet çmim për familje, tek ne merren një herë në javë mbeturinat. Këtu, siç e kemi propozue edhe herën e fundit, është mirë mos me e ndryshue këtë çmimin, me e lënë në 4.50 euro. Këto janë kregjta propozime. Te çmimi për individ – 4.50 euro – edhe te çmimi për jorezidentë/mërgata – duhet me e lënë vjetore, por vitin e kaluar ne e kemi pasur 15 euro, prej 20 euro në 15 euro. Propozimi im ka qenë 15 euro vjetore për mërgatën. Bizneset në hapësira 1-30 m<sup>2</sup>, vjet kam propozue që, nëse nuk ua rritim çmimin në 5.50 euro sa ka qenë vitin e kaluar, unë kam kërkue që ky propozim të jetë 1-50m<sup>2</sup>, po çmimi të jetë i njëjtë – 5.50 euro. Domethënë, të rritet metri katror, por çmimi të jetë 5.50 euro. Bizneset me hapësira prej 51-100 m<sup>2</sup>, prej 15 euro sa ka ardhë para tri ditë, unë e kam propozue herën e fundit – prej 10 eurove ka qenë – unë e kam propozue 8 euro. Sot do të jetë prapë me këtë propozimin 8, si mbledhjen e kaluar. Edhe te e treta, bizneset me hapësira mbi 101 m<sup>2</sup>, këtu ka qenë 15 euro, ju e keni pru me 21, po unë prapë jam për propozimin 12 euro. Kostoja e kontenierit për metër kub, propozimi është 13 euro, ne vitin e kaluar e kemi bo 10 euro, edhe sot është ky propozim, me 10 euro. Edhe kostoja e kontenierit me 7 metër kub, nga 50 në 40 euro. Do të filloj me shkollat, tarifrat caktohen në bazë të nxënësve dhe punëtorëve të shkollës. Nga 15 m<sup>2</sup> në 12 cent, por edhe tarifa e institucioneve tjera zyrtare, lokale, stacione policore, ambulanta, nga 15 cent në 12 cent. Kurse, tarifa minimale për pastrimin e qytetit – siç e kam thënë edhe mbledhjen e kaluar – kjo pak është ma luks, nga 15 cent në 20 cent. Domethënë, këtë do ta rritim, për pastrimin do ta rritim se është pak më luks. Këto janë propozimet e mia. Unë nuk e di kryetar, edhe ju qeverisje, ju keni ardhë për qytetarët, ju në fakt me këtë Rregullore jeni duke ia vështirësue qytetarëve jetën dita e ditës sa më shumë. Përderisa e hypish çmimin, kfadatura 50 m<sup>2</sup>, shkojsh prej 15 në 21, unë nuk e shoh të arsyeshme për me ia rrit, 21 euro me i pague për 50 m<sup>2</sup> për muaj për mbeturina. Këto ishin propozimet e mia. Faleminderit!

**Jetmir Ajdini:** Përshëndetje për të gjithë! Në lidhje me Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave, do të isha ndalë te mbeturinat e ngurta ndërtimore. Komuna jonë aktualisht nuk ka një deponi për mbeturina të ngurta ndërtimore. E dinë shumica prej këtyre që janë këtu prezent, në shumicën e fshatrave ka vende ku hidhen mbeturinat e ngurta ndërtimore. Konkretisht po flas për fshatin Zgatar, është në pjesën e Gjermanit një deponi ilegale e ngritur. Në njërën prej seancave kam propozuar që Komuna të reagojë dhe të mbyllë atë deponi ilegale, të bëjë pastrimin e atij terreni. Nuk kemi pas asnjë reagim. Mendoj se është shumë urgjente që Komuna të gjejë një hapësirë të përshtatshme për ngritjen e një deponie për mbeturinat e ngurta ndërtimore. Besoj se është shumë urgjente edhe të bëhet pastrimi i atyre terreneve që janë bërë deponi ilegale. Pasi të formohet kjo deponi, të gjejmë një mënyrë qysh me i pastrue ato deponitë të cilat janë ngrit ilegalisht, edhe shumica e bizneseve private i shfrytëzojnë ato në mënyrë shumë të lehtë, pa pas nevojë për pagesë, pa pas nevojë për kurgjo tjetër, veç shkojnë i hedhin edhe e ndotin ambientin. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, meqenëse jeni ankuar edhe në kohën kur unë kam qenë kryesues, që po ndodhin ndryshime e ndryshime. Prapë na ka ardhë materiali i seancës, pastaj plotësim-ndryshimi. Jeni ju, të nderum delegatë, që vazhdimisht më keni akuzuar për ndryshime për material ekstra. Ne si LVV, pa u përmbyll dhe pa ardhë si pikë e rregullt e rendit të ditës me zero ndryshime, nuk do ta mbështesim këtë pikë të rendit të ditës.

**Shpetim Hajredini:** Atëherë, besova që Dritoni pak do ta prek qet çështjen, por nuk e preki. I nderuar drejtor, çka mendon ti, pse për shembull tarifrat e taksës së mbeturinave caktohen në bazë të hapësirës së objektit? Pse nuk keni shkuar t'i përcaktoni në bazë të veprimtarisë së biznesit. Ai mund të jetë një objekt 300 m<sup>2</sup>, po ai nuk hedh fare mbeturina. Ka biznes të tillë, për shembull. Ose ndoshta më pak se një individ hedh mbeturina dhe atij biznesi t'i ngarkojmë ne një shumë absurde për mu është, kjo nuk është në rregull. Është dashtë të diskutohet, të shikohen pak edhe rregulloret e komunave tjera, të merret një shabllon i arsyeshëm për Komunën tonë. Prandaj, mendoj që këtu është bërë një lëshim dhe nuk është e arsyeshme që mbeturinat, të përcaktohet shuma në bazë të hapësirës së objektit. Absolutisht, unë jam kundër kësaj, se e thashë edhe më herët, objekti mund me qenë shumë i madh, mirëpo për ju

është shumë punë e vogël. Ju faleminderit!

**Samidin Xheladini:** Delegatë të nderuar, para nesh e kemi një Rregullore e cila përmban 17 faqe. Ne nuk jemi duke debatuar fare për nenet, edhe formën e qëllimin, dispozitat e përgjithshme. Këto krejt i kemi lexue, po nuk i kemi debatue dhe nuk po i debatojmë këto fare. Këto janë shumë mirë të detajuara, se na po e votojmë një statut të Komunës dhe është një statut shumë i mirë. Statutet e kalume janë përmirësuar dhe janë marrë parasysh edhe rrethanat dhe kushtet dhe avancimet që janë bërë deri më tash, si dhe vërejtjet e dobësitë që kanë qenë në të kaluarën. Prej këtyre 17 faqeve, me propozimin e ri i është hequr vetëm faqja e fundit. Na është dhënë një version prej dy faqesh që, me siguri në koordinim me kompaninë, kanë gjet mirëkuptim, pasi që na ka ardhë neve zyrtarisht. Faktikisht, shërbimi i Kuvendit na ka pru neve me siguri me pëlqimin edhe të qeverisë, edhe të organeve gjegjëse, kanë ra në ujdj me siguri – nuk jam kompetent edhe nuk due unë me dhënë përgjigje për atë punë – por, unë me sa e vërejta vetë, e pashë që ka një harmoni, një qëndrim, faqja e fundit faktikisht, te çmimet, arsyetohet me dy faqet që janë shtue shtesë, edhe janë shumë të mira. Qato duhet me i analizue edhe me e kqyrë. Sa për lirime, në qoftë se hyjmë në lirime, duhet me hy edhe në kategori tjera. Nuk është në rregull dikënd me e diskriminue. Ose hyjnë në lirim krejt, qysh e parasheh ligji i Kosovës kush duhet me u lirue, ose në qoftë se bëjmë na seleksionim, atëherë po bëjmë fushatë politike faktikisht. Nuk është mirë që ne si Kuvend të bëjmë hapa të gabuar. Faleminderit!

**Agron Gashi:** Së pari ju përshëndes të pranishëm! Përshëndetje, kryetar, kryesuese dhe të gjithë kolegët e tjerë! Unë me vëmendje i dëgjova disa rekomandime të kolegëve, të cilët dhanë propozimet e tyre lidhur me çmimet që duhet t'i përgjigjen qytetarit. Unë veç pak dua t'ju rikujtoj se Komuna jonë është në ndërlidhje me Komunën e Prizrenit, Zyrën Regjionale të Prizrenit, e cila ngërthen në vete pesë komuna të tëra dhe sa herë mbahen mbledhjet poshtë, kemi edhe nga Komuna jonë përfaqësues i cili merr pjesë në bord. Ngaa aty dalin propozime dhe rekomandime të cilat të paktën duhet të kenë gjithë komunat, një parafrazim. Unë pro konsideroj se këto çmime nëpër komunat e tjera veç kanë ecur, kanë kaluar për një kosto edhe më të lartë. Dhe, nga kjo dua të them se kostoja e cila është përcaktuar ka edhe një bazë nga Zyra Regjionale e Prizrenit, ku bëjmë pjesë edhe në atë zyrë. Andaj, ne japim propozime dhe lloje të ndryshme të çmimeve, por gjithmonë duhet t'i kemi parasysh anën ligjore, krahasimin me komunat e tjera, ku gjendemi dhe çfarë duhet të veprojmë. Edhe një herë e përsëris, në komunat e tjera me një kosto edhe më të lartë se nga këto çmime që janë propozuar nga ekzekutivi i tanishëm. Faleminderit!

**Munir Jonuzi:** Para nesh është leximi i dytë i Rregullorës për menaxhimin e mbeturinave, e kemi diskutuar edhe herën e kaluar për këtë Rregullore, në atë seancë u fol shumë për këtë Rregullore, kur thashë se çfarë gjërash duhet të përmirësohen, e shoh. se ky është një version shumë më i mirë i Rregullores. Në këtë rregullore janë përfshirë edhe disa propozime të vitit të kaluar. Fillimisht do të flas për mbeturinat inerte, pozitive është se në këtë rregullore ishte përcaktuar se sa herë do të trajtohen mbetjet e mëdha, inerte. Në këtë rregullore thuhet se duhet të jetë të paktën një herë në vit, që do të thotë se mbetjet e mëdha, inerte mund të trajtohen disa herë gjatë vitit. Mbetjet e mëdha është më mirë të trajtohen gjatë sezonit, kur numri i banorëve është rritur. Kështu, një numër më i madh i qytetarëve do të përfitonin nga ky veprim. Është e vështirë të shihet se mbeturinat inerte janë numri më i madh i deponive ilegale në komunën tonë, për këtë arsye kemi një numër të madh të deponive ilegale dhe në gjashtë muajt e ardhshëm operatori duhet të bëjë një orar për pastrimin e atyre deponive ilegale. Ajo që dua të propozoj është për masat ndëshkimore, thotë rregullorja, neni 20, dispozitat penale, 20.1 që ata që nuk paguajnë tarifën për pastrimin e mbeturinave, do të inicohet proces gjyqësor për vjeljen e tarifave përmes përmbaruesit privat. Propozimi im është që këtu të shtohet një pjesë tjetër e tekstit që do të lexohet, përveç atyre fshatrave që aktualisht nuk janë në sistemin e menaxhimit të mbetjeve. Kjo do të thotë se kemi ende disa fshatra që nuk janë në sistemin e menaxhimit të mbetjeve, kjo nuk vlen për ta. Në mënyrë që këto fshatra të mund t'i bashkohen sistemit, të japin sugjerimet dhe mënyrën e tyre të të menduarit, si të bashkohen me sistemin e pastrimit të mbeturinave. Për të dhënë një kontribut të përbashkët, në mënyrë që të gjitha fshatrat të përfshihen në këtë sistem. Sa i përket çmimeve, do të sugjeroja që depozitimi në deponin e qytetit të jetë 8 euro për ton, sepse në këtë mënyrë po

subvencionojmë dhe ndihmojmë një pjesë të qytetarëve tanë që kryejnë shërbimin e hedhjes së mbeturinave në deponin e qytetit, faleminderit.

**Nuhija Tairovci:** Përshëndetje të gjithëve, shumë prej jush e keni vërejtur se ka pasur një ndryshim drastik në lidhje me sistemin e grumbullimit të mbeturinave, ka pasur një ndryshim që komuna nuk merr përsipër të mbledhë mjete për pastrimin e mbeturinave, kjo do të nënkuptonte detyrime shtesë dhe kosto shtesë për bashkia. Prandaj të gjithë anëtarët që ishin të detyruar të merrnin këtë reformë, korrigjimi u eliminua aty ku ishte e mundur. Përfitoj nga rasti për të kërkuar falje për të gjitha gabimet teknike që janë bërë gjatë procesit të përshtatjes së rregullores. Pikërisht një nga ata anëtarë është anëtari që flet për raste sociale dhe institucione fetare. Të cilat në rregulloren e vjetër ishin të përjashtuar nga pagimi i të gjitha taksave. Rastet sociale janë të shumta, kjo do të thotë se nëse do të hiqeshin rreth 1000 përdorues apo taksapagues për pastrimin e plehrave, do të vinte në dyshim ekzistenca e kompanisë që grumbullon plehrat, gjë që nuk është në interesin e askujt. Neni 14.3 në lidhje me institucionet fetare duhet të kishte mbetur në tekst për një datë të ardhshme. Aktualisht eko rajoni nuk faturon asnjë institucion fetar për shërbimin e pastrimit të plehrave. Sa i përket listës së çmimeve, ne e bëmë atë në konsultim me rajonin Eco dhe agjencitë që insistojnë që të gjitha tarifat të rriten për shërbime të caktuara në rajon. Kudo është 6 euro. Tek ne është 5.5. Ndonëse ka pasur këmbëngulje për ta rritur në 7 euro. Propozimi i Jetmirit se mbetjet inerte, trajtimi i mbetjeve inerte është baza për zgjidhjen e shumë problemeve. Për zyrat e partive politike, ato mund të mbulohen me nen ose të përjashtohen nga pagesa. Propozimi i Shpëtimit, se si të grumbullohet nga bizneset apo sipërfaqet, si dhe nga shtëpitë, një person në një familje nuk mund të krijojë mbeturina si një familje shumë anëtarësh. Deponimi në landfillin e qytetit është një propozim nga Bordi, ndoshta duhet të jetë më poshtë. Eko Restelica i çon mbeturinat në deponi dhe pagan për ton, në këtë kuptim, duke pasur parasysh se ato ekzistojnë me donacione që çmimi të jetë i pranueshëm për të dyja palët. Ne presim që të miratohet Rregullorja dhe më pas të fillojmë një fushatë për përfshirjen e fshatrave në sistem.

**Nedžmidin Sejdilar:** Përshëndetje të gjithëve, zotri Tairovci, kontejnerët në Dragash janë vendosur në vende joadekuate. Ato kontejnerë krijojnë një imazh të keq për komunën. A keni menduar se si t'i hiqni plotësisht kontejnerët nga qyteti. Se ndoshta ne përdorim qese plastike apo kosha individuale, ku do të dihet se në cilën ditë kompania do të nxjerrë mbeturinat dhe më pas qytetarët do t'i hedhin mbeturinat e tyre. Problemin më të madh gjatë përmbajtjeve e krijuan mbeturinat, të cilat bllokuan përrenjtë. Dikush nuk e hodhi atë plehra. Unë jam i interesuar nëse keni module për heqjen e kontejnerëve. Nuk ka mbijetesë në qytetin tonë nëse nuk zhvillojmë turizmin dhe kjo mund të ndodhë nëse komuna jonë është e pastër. Kontejnerët janë kudo, janë plot me mbeturina, erë të keqe. Ai jep një shembull të keq për të gjithë.

**Nuhija Tairovci:** Në Planin e Punës të drejtorisë sonë thuhet se kemi planifikuar të krijojmë apo ndërtojmë zona të gjelbra, shtëpiza ku do të vendoseshin kontejnerët, të cilat do të dukeshin shumë më kulturore. Një metodë tjetër është vendosja e koshave në të gjithë qytetin, disa kosha në distanca të caktuara. Kur përmendët fshatin Radesa, ky është një tregues i qartë se duhet ta mbështesim Eco Restelicën me një automjet më të vogël. Në mënyrë të tillë që të arrihet të arrihet në të gjitha lokacionet e fshatit dhe të shmangët krijimi i deponive ilegale. Ne duhet të përcaktojmë vendndodhjet dhe mënyrën e instalimit me drejtorin e Urbanizmit.

**Jetmir Ajdini:** Drejtor, e kam një pyetje konkrete për ju. Pasi që ju funksiononi në kuadër të Ekoregjionit, nën ombrellën e Ekoregjionit, a keni provue ndonjëherë që të bëni një marrëveshje me Ekoregjionin për shfrytëzimin e deponisë së ngurtë ndërtimore në fshatin Zhur. Përderisa Komuna jonë nuk ka një deponi të tillë, bëni marrëveshje me Ekoregjionin për shfrytëzimin e asaj deponie në fshatin Zhur për hedhjen e këtyre mbeturinave të ngurta, për arsye se çdo ditë rritet numri i deponive ilegale në Komunën tonë, për shkak se Komuna nuk posedon një deponi të tillë. Pyetje shumë konkrete për ju, drejtor.

**Artan Loshaj:** Përshëndetje për të gjithë! Unë si diskutues gati i fundit, e kam shumë shkurt, se kolegët veç kanë diskutue, mos t'i përsëritim. Për në foltore më nxiti pak Muniri, që tha në ato pjesë ku nuk shkon edhe nuk është në sistem, të mos paguhen, unë e kisha pas një propozim, se edhe këta qytetarë

jetojnë në Komunën e Dragashit. Në qoftë se nuk mund Ekoregjioni me shkue atje, këta dikund i gjuajnë këto gjybret, këto mbeturinat, atëherë unë kisha propozue për shembull, një qytetar që është në mërgatë bare 20 euro mujore me pague, e jo me u lirue krejt nga taksat. Drejtorin edhe Ekoregjionin e kemi këtu, ish-kolegën, sa përqind të qytetarëve janë në sistem të Ekoregjionit të cilët paguajnë? Çka është t'u ndodhë – kryetar, shumë mirë e dish se vitin e kaluar i kemi votue dy deponi që do t'i formoni, nëra ishte në fshatin Rrenc, njëra për sa më kujtohet. A e keni pas veç sa për performancë, për me e kalue këtë, apo çka është t'u ndodhë. Kjo Komunë, a ka inspektorë, a punojnë ata inspektorë për parandalimin e këtyre mbeturinave? Se në çdo fshat ka deponi ilegale. Mos të diskutojmë më për me e dënue ndonjë qytetar, por së paku bare me dalë me i vërejt këto, se çdo ditë e më tepër jemi t'u bo deponi ilegale. Edhe unë kisha propozue, si krejt kolegët, që familjet e dëshmorëve edhe bashkësitë fetaretë largohen nga participimi, si dhe të gjitha bizneset tona të lirohen nga pagesa, jo krejt, po në minimum me shkue, për arsye se është Komunë e vogël, bizneset punojnë veç në sezonin veror, tre muaj, katër muaj. Domethënë, këto tariffa që i kanë qit janë shumë të larta. Unë i përkrahi kolegët, që sa më pak të bëhet... edhe, në qoftë se edhe një herë, drejtor, a ka mundësi me na kallxue, se 25 vite shkuan, me na kallxue sa përqind e qytetarëve të Komunës së Dragashit janë në sistemin e Ekoregjionit. Edhe, pasi dy-tre herë e përmende që nuk ka mundësi Ekoregjioni, unë kisha propozue këtu që dampera, dy a tre, katër a pesë, sa ka nevojë, në qoftë se ke diskutue me këtë, prej buxhetit, tash e kemi buxhetin muajin tjetër, t'i ndajmë 10 mijë, 20 mijë, 30 mijë, sa kushtojnë me i ble ato mjetet, dhe t'ua mundësojmë këtyre edhe qytetarëve, sa më lehtë me ardhë deri të qytetari. Faleminderit!

**Agron Gashi:** Edhe një herë unë desha të kyçem. Nëse lidhemi me të kaluarën e deponisë ekzistuese, ka një historik goxha të keq, meqenëse edhe është në trevën tonë, aty afër fshatit Brezne, veprimi i asaj deponie ka shkëlur të gjitha parametrat e funksionimit. E kam fjalën për të kaluarën. Mirëpo, gjendja aktuale se si gjendet sot, ndoshta ka ndryshime, përmirësime, por nuk është ajo që dëshirojmë ne. Për ju drejtor, shkurt, disa pyetje, unë besoj se keni barriera të shumta lidhur me funksionimin e kësaj deponie, duke u nisur një herë në inkasim. Keni borxhe, qytetarët janë mjaft borxh ndaj kompanisë suaj, duke mos iu përgjigjur pagesave të rregullta mujore. Për atë arsye edhe konsideroj se ka paraqitur shumë vështirësi në funksionimin e kësaj deponie sipas standardeve që duhet të funksionojë. E dyta është që, meqenëse ekzistojnë shumë deponi ilegale në trevën tonë, më herët kam thënë e po them edhe sot, mungojnë tabelat e vendosura për moshedhjen e mbeturinave. Mungojnë broshurat e ndryshme nëpër fshatra të cilat japin rekomandime që mos të hudhen mbeturina nëpër ato ku janë ilegale. Pastaj, unë konsideroj se keni prapë vështirësi në bashkëpunim me Inspektoriat komunal, sepse inspektorët e Komunës paraprakisht duhet të kryejnë punët e tyre me deponitë ilegale, dikush edhe të qortohet edhe t'i jepet vërejtja apo të dënohet, sepse vetëm dënimet në botën e modernizuar shërojnë plagët. Dhe, besoj se mosinkasimi ka paraqitur vështirësi edhe në teknikën që e posedoni, me kamion, eskavator e gjësende të ndryshme, sepse për çdo hedhje duhet të ketë edhe mbulesë. Ajo nuk ka ekzistuar. Tani, në kontakt me erën, me dukuritë natyrore, janë shpërndarë dikur më herët, edhe ajo pjesë që ka qenë, ku është pjesë e deponisë, ka pasur edhe burime të mira natyrore, ato janë shkatërruar të tëra, u shkatërrue ambienti ekologjik në ato pjesë. Konsideroj që duhet të punohet edhe në këto drejtime, në bashkëpunim me Inspektoriatin dhe qytetarët, për t'i bindur se inkasimi duhet të ndodhë për një ambient, për një mirëqenie më të mirë, rreth natyrës. Faleminderit!

**Bexhet Xheladini:** Të nderuar të pranishëm, kjo Rregullore gjithsesi që duhet të miratohet. Është kërkesë ligjore që kjo Rregullore duhet të miratohet. A duhet të miratohet në formën që e kemi çue ne si ekzekutiv apo të ndryshohet, kjo varet prej jush. Këtu të gjithë pajtohemi se ne duhet të angazhohemi për një ambient të pastër. Këtë ambient të pastër ne mund ta mbajmë nëse e ndryshojmë këtë Rregullore, edhe kërkojmë nga kompania që të jetë e përgjegjshme. Ne këtu po flasim për një kompani publike, që kërkojmë përgjegjësi, ndërsa nga ana tjetër, këtu dëgjova propozime që disa kategori të qytetarëve të lirohen nga pagesa. Nëse kjo kategori shumë e madhe e qytetarëve lirohen nga pagesat, kush do t'i paguajë shpenzimet e këtyre mbeturinave që kompania duhet t'i mbledhë. Kompania nuk është shoqatë humanitare, as bamirëse, ajo është kompani e cila ka të punësuar, por është kompanie e cila edhe duhet të bëjë investime. Është kompani e cila vazhdimisht punon me humbje, për shkak të çmimeve ekzistuese

dhe çdo herë humbjet i ka mbulue regjioni, me vullnetin e mirë të Kryeshefit Ekzekutiv, z.Burim Shala. Ne juve jua kemi dorëzue verzione të kësaj Rregulloreje, verzionin e parë të cilin e keni marrë në bazë të ligjit, i cili ka pas disa lëshime teknike, që kanë qenë kryekëput lëshime që i ka bo vetë drejtori, dhe pastaj, në një takim që e kemi pas me kryeshefin ekzekutiv, ku ka marrë pjesë edhe drejtori edhe unë si kryetar, edhe kryesuesja, ju kemi kërkuar falje dhe ju kemi çue edhe disa ndryshime të disa neneve të aneksit A të Rregullores. Këtu kishte propozime për ulje të çmimeve, kishte propozime që të mbeten çmimet e njëjta, kishte propozime që të lirohen nga pagesa. Gjithashtu, ishte edhe propozimi i Munir Jonuzit, i cili ishte një propozim që mundet me qenë i akceptueshëm, për arsye se propozon që në dënim të mos përfshihen fshatrat të cilat momentalisht nuk janë në sistem. Megjithëse edhe Rregullorja e parasheh këtë, që dënimi do të jetë për ata të cilët janë të përfshirë në sistem, ndërsa ata të cilët nuk janë të përfshirë në sistem, nuk ka mundësi qysh të dënohen. Por, ne do të bëjmë përpjekje që fshatrat të cilat nuk janë të përfshira në sistem, siç tha edhe drejtori, me një kampanjë të vazhdueshme, gradualisht, fshat për fshat, t'i shtijmë në sistem dhe të gjitha fshatrat e Komunës sonë të përfshihen në sistemin e menaxhimit të mbeturinave. Lirim nga pagesa e disa kategorive, nuk e lejon ligji. Unë po e lexoj këtu: Ligji Nr.01/L60 për Mbeturinat dhe ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.081-071 – Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ky ligj nuk lejon që asnjë kategori të lirohet nga pagesa. Dhe nëse ne e miratojmë këtë Rregullore, Ministria këtë Rregullore e kthen në rishqyrtim dhe ne duhet patjetër, andaj nuk duhet të bëjmë dy herë punë. Ndërsa, sa i përket liritimit të objekteve fetare nga pagesa, është një marrëveshje interne në mesa të këshillave të Bashkësisë Islame edhe Ekoregjionit që këta nuk faturohen. Këtu e kemi edhe përfaqësuesin i cili mund ta vërtetojë. Edhe tash e tutje, edhe konfirmimin që e kemi marrë prej kryeshefit ekzekutiv të Ekoregjionit, ne nuk do të përfshijmë këtë në Rregullore, mirëpo kompania nuk do të bëjë faturimin, ose do ta bëjë faturimin me zero-zero pagesë. Sepse, nëse e qesim që objektet fetare lirohen, atëherë Rregullorja na kthehet prapë. Unë mendoj që ne si delegatë duhet t'i ndihmojmë edhe kompanisë, që ajo të mbahet në këmbë të veta dhe të funksionojë, për arsye se ka mbi 10 vite e ma shumë që nuk janë ndryshue çmimet. Ju e dini që pagat janë rrit, shpenzimet janë rrit, karburanti është rrit, rryma është rrit, të gjitha gjërat janë rrit, gjithashtu edhe mirëmbajtja e automjeteve të cilat i kanë është rrit. Kështu që, me këto çmime, nëse ne nuk e bëjmë miratimin e kësaj Rregulloreje me çmimet e propozuara, atëherë do të qesim kompaninë në një pozitë jashtëzakonisht të palakmueshme. Andaj, unë propozoj që qato ndryshimet të cilat i propozoi z.Muniri, ndryshimin e atij Nenit ku thuhet që mos të përfshihen në dënim fshatrat që nuk janë të përfshira, edhe këto dy kompanitë private të cilat po funksionojnë shumë mirë në Komunën e Dragashit, Brodi edhe Restelica, të zvogëlohet tarifa nga 9 në 8 euro. Faleminderit! Kemi disa propozime, kryesuesja mund t'i qet të gjitha në votim.

**Shpetim Hajredini:** Atëherë, i nderuar kryetar, propozimin tim të cilin e dhashë unë në fillim, e kam dhënë edhe kur e kemi diskutue Rregulloren vitin e kaluar. Atëherë nuk më ke thënë që me ligj ndalohet, tash thaje me ligj. Qat ligjin, a ka mundësi unë ta shoh edhe ta lexoj vetë, për propozimin tim. Propozimin të cilin e dhashë, për lirim të familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe për xhamitë, që të lirohen nga pagesa. Në bazë të asaj që e dëgjova unë, ti thaje që me ligj kjo nuk lejohet. A ka mundësi unë ta shoh qet ligj, qysh me besue unë tash a është e ndalume. Atëherë e qesim në votim. Pata me e tërheq propozimin, nëse është e kundërligjshme. Tash nuk po japin prova, atëherë del në votim.

**Arijeta Skeraj:** Para se me e marrë fjalën Sejdilari, deshta veç me tregue që në Rregulloren, Nenin 10, Pika 1, replikat eventuale nuk mund të zgjasin më shumë se dy minuta, po Pika 1.3 – askush nuk ka të drejtë diskutimi më tepër se një herë për një çështje të njëjtë. Kështu që, për hir që dy-tri herë e ngrite dorën, po ta jap fjalën. Unë e di Rregulloren, por në eventuale do t'i sqaroj disa gjëra me ty.

**Nedžmidin Sejdilar:** Kryesuese, meqenëse ju po zbatoni ligjin vetëm për mua, më thoni që edhe kolegët e mi kanë folur disa herë. Tani jam këtu për të përkrahur kryetarin e komunës kur tha se duhet të përkrahen organizatat që ofrojnë shërbime të mira për qytetarët e Brodit dhe Restelicës. Që tarifa të ulet në 8 euro, nëse mund të ulet edhe pak. Sepse këto organizata financohen nga fondet e qytetarëve. Fshatrat tanë janë bosh gjatë dimrit. Unë sugjeroj që ta ulim nga 9 euro në 7 euro.

**Samidin Xheladini:** Një prej historive të lavdishme që e ka bo Kosova është organizimi i kompanive



për menaxhimin e mbeturinave. Edhe një punë shumë e mirë është – krejt e dimë na para luftës qysh kemi veprue. Ne duhet me i kontribue kësaj kompanie, se me bo me bankrotue kjo kompani, çka bëhet deri të formohen të tjerat. Ju mos u mërzitni, unë mërzitem, se unë e di çka më ka ndodhë mu, kur u duhke ku me i çue mbeturinat, kujt me ia hudh. Po thuhet me vu pllaka. Jo jo, kahmos është e ndalume hudhja e mbeturinave, vetëm në vendin adekuat me i marrë kompania. Kërkund në botë nuk lejohen mbeturinat me u hudh. E dimë mirë, mos të bëjmë jo kështu, jo ashtu. Edhe në çështje të mbeturinave mos të bëjmë marketing politik edhe personal. Krejt jemi të barabartë, të njëjtë edhe krejt dona me e dhënë kontributin. Jo dikush unë propozoj këtë, me e ndie ai qytetari atje zotninë e nderuar, qe unë e ula çmimin. Ne i dimë këto, ne dimë më shumë me dhënë propozime, po duhet të jemi konkretë, edhe mo këso zëra mos të ndodhin këtu në Kuvend, se na jemi kundër e ata janë për. Ju faleminderit!

**Artan Loshaj:** Kryesuese, shumë shkurt! Ma herët kryetari tha që këtë Rregullore duhet mos me e ndryshue. Unë po mendoj se kjo Rregullore duhet të ndryshohet. Kërkoj përgjegjësi nga kompania – po është e vërtetë, po këtë kompani duhet me mbështet na – unë edhe parëz e propozova që në ata fshatra që s'mund me shkue kamioni i madh, duhet do dambera me jau ble, se çdo komunë i ndihmon krejt kompanitë, për arsye se na votën e kemi lyp nga qytetari, për të mirën e qytetarëve, për pastrimin e vendit, për ambient të qetë, edhe për një turizëm. Për me u bo këto, ne e dimë kompania që nuk ka mundësi, jo që nuk do. Atëherë ne duhet, thashë edhe një herë, prapë po e përsëriti, që në muajin shtator 20 mijë a 30 mijë euro t'i ndajmë edhe t'i blejmë disa dampera. Prapë kryetari e mbështeti propozimin e Munirit. Nuk jam kundër Munirit, absolut, jemi kolegë. Mos me u dënue edhe mos me participue. Edhe ata qytetarë janë të Komunës së Dragashit, edhe propozova dhe prapë i rri karshi këtij propozimi që së paku të paguajnë si mërgata, se edhe ata janë qytetarë të Komunës së Dragashit. Të gjithë këta qytetarë të cilëve nuk u shkohet për t'ua mbledhur mbeturinat, ata i gjuajnë nëpër deponi private, ose me thas e me kese i gjuajnë këtu në qytezën e Dragashit. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Artan! Atëherë, besoj që s'ka mo diskutues tjerë. Këtë Rregullore e kanë përgatitur Komisioni profesional. Edhe unë jam që të mos ngarkohen qytetarët për çmime më të larta. Mirëpo, krahasuar me komunat tjera, këto çmime janë minimale, në mënyrë që të mund të funksionojë kompania. Në të kundërtën, ndoshta nuk mund të ofrojnë shërbime kompania. Atëherë, po fillojmë me propozimet. Propozimi i Shpetimit, tash po i qesim një nga një. Propozimi i Shpetim Hajredinit është që ndërtesat fetare Po edhe kryetari e tha që ndërtesat fetare nuk do të participojnë. Familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe veteranëve. Atëherë e qesim në votim propozimin e Shpetim Hajredini. Kush është pro këtij propozimi që të futet në Rregullore? A ka kundër? Abstenim? Propozimi i Shpetim Hajredinit, me 11 vota pro, 13 kundër dhe 0 abstenim, nuk futet në Rregulloren e mbeturinave. Propozimi i dytë, i Dritonit, zyret e partisë të lirohen ose të paguajnë si mërgata, edhe çmimet të mos jenë 4.5, jorezidentët 15 euro vjetore, bizneset 1.3 – 30 deri 50, 5.50 euro; bizneset 50-100 m2 të jenë 8 euro; edhe mbi 100 m2 të jenë 12 euro. Kush është pro propozimit të Dritonit? A ka kundër? Abstenim? Me 12 vota pro, 13 kundër dhe zero abstenim, edhe kjo nuk futet në Rregullore. Propozimi i Jetmir Ajdinit, mbeturinat e ngurta dhe deponitë. Drejtori tha që kjo është e përfshime në Rregullore. Nuk kemi nevojë me e qit, ose që duash, e qesim në votim. Në rregull. Z.Munir Jonuzi, përveç atyre fshatrave që nuk janë në sistem, ato fshatra të kyçen në sistem, edhe deponinë e qytetit, prej 9 të bëhet në 8 euro. E qesim në votim propozimin e Munirit. Kush është pro këtij propozimi? A ka kundër? Abstenim? 13 pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet propozimi i Munirit. Propozimi i Artan Loshajt, që fshatrat në sistem së paku të paguajnë 20 euro vjetore; familjarët e dëshmorëve të lirohen dhe bizneset të taksohen me shumën minimale. Kush është pro këtij propozimi të Artanit? A ka kundër? Abstenim? Me 12 vota pro, 13 kundër dhe zero abstenim, edhe ky propozim nuk miratohet. Propozimi i fundit është i Nedžmidin Sejdilarit, të zbritet nga 9 deri në 7 euro. Kush është pro këtij propozimi? Duhet me e qit si propozim i Nedžmidin Sejdilarit. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 2 vota pro, 13 kundër dhe zero abstenim, edhe ky propozim nuk miratohet. Atëherë, siç edhe thashë edhe më herët, una kam qenë një ndër pjesëmarrëset prej drejtorit të Ekoregjonit. Mu më vjen keq që propozimet e juaja – pasi unë vetë mundem me dalë keq – se unë krejt, bashkë me drejtorin edhe me kryetarin, edhe me atë e kam bo, edhe unë nuk mundem me qenë kundër

kësaj Rregulloreje. Atëherë, e qesim në votim Rregulloren. Kush është pro kësaj Rregulloreje, me ndryshimin e propozuar? A ka kundër? Abstenim? Me 12 vota pro, 7 kundër dhe zero abstenim, e miratojmë Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave. Atëherë, kalojmë te pika tjetër: Diskutim për vitin shkollor 2024/2025, të kërkuar nga z.Nexhat Selaj.

**Nexhat Selaj:** Pasi që është fillimi i vitit shkollor 2024/2025, unë këtë pikë vetëm e propozova me një kusht, që thashë nga ekzekutivi, s'po them nga kryetari po nga drejtori i DKA-së, ta marrë fjalën, pasi veç qenka këtu, tani ndërkohë do të ndërlihem me pyetje, të na tregojë për të gjitha ato se deri në çfarë niveli, ku ka arritur gjendja e fillimit të vitit shkollor. Nëse nuk është në gjendje dikush nga ekzekutivi, atëherë do të fillojë unë, po me sa shoh, drejtori ka gatishmëri kësaj radhe me dalë. Faleminderit!

**Arijeta Skeraj:** Para se me dalë drejtori, dua edhe unë ta marr fjalën për fillimin e vitit shkollor. Deshta një pyetje, me m'u përgjigj drejtori për Arsim. A ka rënie në numrin e nxënësve në Shkollën e Mesme "Ruzhdi Berisha" dhe a jeni gati që të fillojë ky vit, me gjërat materiale që ju duhen të gjitha shkollave në Komunën e Dragashit?

**Zeni Krasniqi:** I nderuar kryetar i Komunës, e nderuar kryesuese e Kuvendit, të nderuar delegatë! DKA-ja ka bërë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2024/2025, vit i cili do të fillojë më 2 shtator, ditën e hënë. Këtë e konfirmojnë edhe vetë drejtorët e shkollës, me të cilët e kemi pas takimin para dy dite. Edhe teknikisht, edhe rreth normave, edhe me staf janë të gatshëm për fillimin e vitit shkollor. Por unë mund ta them këtë, në përjashtim të shkollës fillore të Restelicës, e cila është në fazën e renovimit, edhe pse unë para dy dite isha edhe vetë prezent atje. Atje punohet me një dinamikë shumë të shpejtuar, është një staf i punëtorëve shumë i madh. Unë iu bëra presion që ditën e hënë ata të jenë të gatshëm. Kanë kryer diku 80% të punimeve edhe besoj që ditën e hënë, ata ma dhanë fjalën, që do të jenë të gatshëm. Nuk e kemi problemin tjetër që është duke u bërë mirëmbajtja në ShFMU "28 Nëntori" në Bresanë. Unë – para se të fillojë takimi – isha në Bresanë me e pa gjendjen drejtpërdrejt, edhe pse menaxherit i kam bërë presion që vazhdimisht të jetë prezent aty. Edhe aty kishin filluar, edhe pse objekti është i vjetër me të thënë të drejtën, puna ishte duke shkuar mirë. Mirëpo, nuk është problemi në këtë shkollë, se ata kanë mundësi që ta shfrytëzojnë shkollën e re. Edhe këtu mësimi pa problem do të fillojë, normalisht me ndërrime, po në objektin e ri të shkollës. Ka përfunduar edhe mirëmbajtja në ShFMU "Shaban Shabani" në Llopushnik, paralelen e ndarë në fshatin Buqe. Përndryshe, ne si Drejtorat kemi marrë pjesë si drejtorë në takimin e drejtorave të drejtorive komunale në arsim, të cilët na kanë njoftuar rreth përgatitjes që i ka bo Ministria e Arsimit. Ne kemi qenë të obliguar si drejtori, që fillimviti të mos na zë pa përgatit, prandaj kemi filluar qysh herët që të bëjmë përgatitjen e dokumentacionit dhe kërkesës, sidomos për Zyrën e Prokurimit, në këto drejtime: Tenderin për furnizimin e shkollave me lëndë djegëse, gjegjësisht dru dhe pelet. Po ju njoftoj se hapja e ofertës për pelet veç është bërë, megjithëse peletin e shfrytëzojnë vetëm dy shkolla, ShFMU "Fetah Sylejmani" këtu në qendër dhe në paralelen e ndarë në Shajne. Edhe janë disa AMF që janë të përfshira në listën tonë, po ato normalisht që bëhet pagesa prej DShMS-së. Kurse për drutë, sipas informatave që i kam marrë nga Zyra e Prokurimit, oferta do të hapet këto ditë për dru. Do të thotë se furnizimi do të bëhet me kohë me dru. Mandej, gjithashtu kemi bërë përgatitjen e dokumentacionit dhe kërkesës dhe e kemi plasuar në Zyrën e Prokurimit për transportin e nxënësve. Ju e dini, edhe këtë vit ne kemi vendosur që transportin e nxënësve, edhe për nivelin e ulët edhe për shkollën e mesme, ta bëjmë falas. Të gjitha përgatitjet i kemi bërë, i kemi dotëzuar në Zyrë të Prokurimit, është hap oferta, pritjet që të nënshkruhet kontrata dhe unë shpresoj që kjo punë do të kryhet si duhet. Kemi disa ofertues që e kanë fituar të drejtën. Edhe tash, si do të rrjedh ajo, ne jemi aty. Mandej, sa i përket rekrutimit të mësimdhënësve, gjithashtu jemi në fazën përfundimtare të konkursit të rregullt, që e kemi shpallë me kohë. Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë dhe klasën e dhjetë është bërë. Megjithëse, unë para se t'i jap përgjigje edhe kryesuese që ma bëri pyetjen, se ndoshta ma vonë harroj, ka përfunduar ky, të gjitha drejtimet janë plotësuar, ju e dini se kemi një vërshim shumë të madh, të gjithë nxënësit janë orientuar në drejtimin e shëndetësisë, të infermierisë, që besoj është një shqetësim i madh edhe për ne edhe për prindërit. Nuk e di a e kanë atë që ta kenë si profesion, apo e kanë orientimin vetëm në perëndim, tregu i punës, që e ka si orientim vetëm botën e jashtme ku është kërkesë shumë e madhe. Ju e dini se ne e kemi dorëzuar

me kohë këtë konkursin. E kemi dorëzue në Ministri edhe i kemi ndarë, i kemi të caktuara paralelet në shëndetësi dy drejtimet: Infermieri dhe Farmaci, ku e kemi numrin e kufizuar – 22 nxënës. Në këtë drejtim, qysh në afatin e parë është plotësuar numri. Edhe pse i kemi pas edhe nja pesë nxënës që i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e konkursit, mirëpo kanë qenë të kufizuar 22. Mirëpo, ne kemi prit, për hir të asaj që të mos shkojnë të gjithë andej, se ne po dobësohemi në drejtime tjera, sidomos në Gjimnazin, ju e dini që e kemi pas një Gjimnaz me shumë renome. Edhe drejtimi i shkencave të natyrës ka qenë ai nga i cili janë orientuar edhe në mjekësi, edhe në teknikë, edhe në ekonomikë, juridik dhe shumë drejtime tjera, kanë dalë edhe shumë kuadra nga këtu. Për atë, që mos t'i lëmë të gjitha aty, se ata po e përfundojnë aty edhe mandej mundësitë tjera s'e di sa janë të shkojnë në fakultete tjera. E sa është numri, unë kam kërkuar prej drejtorit, meqenëse kemi lëvizje, se tash prej këtyre pesë nxënësve edhe ata dy kanë kalue në drejtimin e shkencave natyrore, kurse tre po thojnë kanë shkue në Prizren me e kërkuar të drejtën e vet, nëse gjejnë mundësi me u regjistruar atje. Me ju thënë të drejtën, ende ka dhe pritet që ende të shtohet ky numri, po kryesuese, sikur vitin e kaluar, sipas informatave të drejtorit, sillet numri diku 130, duhet të jetë numri i nxënësve të klasës së dhjetë. Kemi pas fat që të sigurojmë, kemi furnizue me material për nevoja të shkollave, mirëpo ne me qëllim nuk kemi bërë shpërndarjen para kohës, se është një procedurë e regjistrimit të të gjithë këtij materialit, janë disa artikuj që janë si asete, prandaj edhe duhet të regjistrohen në databazë. Atë jemi duke e bërë dhe shumë shpejt, me fillimin e vitit shkollor do ta shpërndajmë këtë material. Materiali është prej gozhdës më të vogël atje, deri te ato si asete që kanë nevojë shkollat. Testi i Maturës, faza e dytë, afati i gushtit do të mbahet nesër. I kemi bërë gjithashtu të gjitha përgatitjet. Administruesit janë caktuar, i kemi dorëzuar qysh në afatin e parë numrin e administruesve, mirëpo Ministria është përcaktuar që një pjesë e tyre të mbetet në afatin e gushtit. Këta i kemi çue prapë, na kanë përcjellë listën, ne i kemi kthyer prapë, se janë këta dhe do të vazhdojnë do të administrojnë Testin e Maturës në Prizren. Kurse këtu te ne është bërë lista e nxënësve, është dorëzue, shkolla ka bërë përgatitjet, si qendër që është, me paralelet, edhe për furnizimin që kanë nevojë nxënësit. Për testin nesër jemi të gatshëm. Kalandari për vitin shkollor 2024/2025, e kanë edhe drejtorët e shkollave, por e kemi edhe në uebfaqen e Ministrisë, me siguri dikush prej jush që ka qenë i interesuar e ka pa. MASHTI, sikur vitin e kaluar, edhe këtë vit ka vendos që furnizimi me tekste shkollore të bëhet përmes subvencionimit të prindërve. Ne e kemi pas mbledhjen diku më 13, edhe kanë thënë që javën tjetër do të fillojmë menjëherë me aplikime. Ju e dini, kemi mbërri në fazën kur kanë aplikue shumë prindër, shumë shpejt dhe një numër shumë i madh brenda disa ditëve, përmes Platformës eKosova, e dinë qysh ata si vitin e kaluar. Mirëpo, na është thënë neve që DKA-ja, gjegjësisht drejtoritë e shkollave, të bashkëpunojnë me prindërit gjithsesi, edhe gjithmonë të orientohemi përmes katalogjeve, aktivët e shkollave mblidhen dhe e përzgjedhin se për cilën shtëpi botuese orientohen. Atë e kanë krye ata, ne kemi kërkuar që ata, listat e përzgjedhjes së këtyre librave t'i qesin në hapësirat ku i shohin prindërit. Ata të bashkëpunojnë që vështirësitë dhe problemet që iu paraqiten prindërve, ata të jenë aty dhe t'i orientojnë. Sepse ka probleme të ndryshme që nuk kanë ditë se si të aplikojnë, megjithëse e kanë një përvojë nga viti i kaluar. Edhe e fundit, kemi marrë informata para dy dite, se të gjitha mjetet, këta aplikantë që është një numër shumë i madh, shumica e mjeteve, kemi informatën prej Ministrisë se janë ekzekutue. Mirëpo, unë atë ditë në mbledhjen e drejtorëve kërkoja drejtorët – listat ua kemi dërguar, të krejt prindërve janë aty – secila shkollë t'i nxjerrë listat e prindërve dhe të nxënësve, dhe të na i dërgojë DKA-së që ne ta kemi një pasqyrë, se cili prej prindërve ka mbet pa u regjistruar. Deri sot nuk kemi, nuk kam as nga shkollat ankesa, ose është vonue – megjithëse ky afati vazhdon – ne në atë takimin vitin e kaluar ajo është realizuar, pagesat janë bërë deri në prill të këtij viti. Na është dërguar edhe një qarkore informuese që ka të bëjë me licencimin e mësimdhënësve, këtë ua kam shpërndarë drejtorëve të shkollave, t'i njoftojmë arsimtarët, mirëpo edhe ju ta keni si informatë, popullata përmes mediave ta di se të drejtë aplikimi kanë vetëm ata të cilët e kanë një vit përvojë pune, që janë adekuat për lëndën që e japin. Unë tjetër s'kam më tepër, këto që kemi mund, besoj që janë të mjaftueshme që ta kemi një vit të mbarë dhe të suksesshëm. Ne si Drejtori, edhe prej drejtorave kërkoja nja arsim cilësor, që të ketë një disiplinë të madhe, një përkushtim më të madh të personelit arsimor. Kështu që, të mos i drejtohen gjithmonë, po ata i kanë t'i shfrytëzojnë ligjet

dhe aktet nënligjore, udhëzimet administrative, rregulloret e të gjitha. Për të gjitha ato që rrjedhin në shkollë, qoftë mungesat ose qoftë incidentet e vogla, mos t'i drejtohen menjëherë DKA-së, mirëpo të mundohen që t'i përdorin të gjitha ato masa deri aty ku ata e kanë të drejtën. Unë, sa për fillim të këtij viti kaq kam. Faleminderit!

**Driton Ademi:** Përshëndetje për të gjithë! Atëherë, po ia nisi me një pyetje, drejtor. Cili është ndryshimi nga viti i kaluar, as subvencionimit të pagesave të nxënësve në Gjinnaz, cili është ndryshimi nga viti i kaluar në këtë vit që janë regjistruar nxënësit në Gjinnaz. Me sa e kam pa unë, ti tha që janë vërshue shumë në infermieri edhe në mjekësi, në mos gabofsha. Unë po të pyes, pse në afatin e dytë në Farmaci nuk keni qit konkurs hiç? Nuk e kam pa unë, as nuk e kam pa listën e pranimit që e qitni para shkollës. Me sa kam mund me mbledh informacion, rreth 80 nxënës janë regjistruar, e jo sa thatë ju. Që e kam pa që e keni qit në hyrje të shkollës. Pyetja e dytë është – drejtor – pse kaq vonë bëhet lysterja në shkollën e Bresanës, që ka fillue para një jave? A ka me fillue mësimi më 2 shtator, të hënë, a jo? A janë të përgatitur për me fillue më 2 shtator? Edhe një pyetje te tekstet shkollore, unë e di që kanë zgjedhë grupe punuese për zgjedhjen e teksteve shkollore. A është ndonjë farë konflikt interesi prej mësuesve, tek tekstet shkollore. Me sa e di unë, ka disa që janë prej botimeve, njerëz të vetit që i kanë përzgjedhë këta. E para, e dyta: është shumë problem disa tekste shkollore për me i gjet, të cilët këta i kanë përzgjedhë. Unë e kam rastin, fëmija jem që është shumë problem me i gjet nëpër Prizren tekstet shkollore të klasës së shtatë, disa prej tyre, jo të gjitha. A do të bëjë ndonjë ndryshim – nuk po due me i përmend botimet shkollore kështu – a do të mundet me e bo një ndryshim, nëse nuk gjendet ai botim shkollor me kohë, që njerëzit mos me shkue me i ble tekstet e ndryshme. Edhe në fund, drejtor, kisha kërkue një pyetje shumë më konkrete. Secila shkollë në Komunën tonë ka faqe në rrjetet sociale. Është mirë që, para fillimit të vitit shkollor, me dalë me një njoftim, me i njoftue nxënësit, ose çfarëdo njoftimi që të kenë shkollat, apo pushime, ose diçka tjetër, është mirë me dalë me i njoftue me një njoftim në rrjetet sociale. Se ne e dimë që në ditët e sotit është bota krejt në rrjetet sociale, është mirë që kush i menaxhon ato faqe të shkollave, është mirë që me u njoftue edhe aty. Faleminderit!

**Nexhat Selaj:** Për të gjitha ato pikat që desha të parashtroj pyetje, drejtor, ma zune rendin. Po më vjen mirë që i paske plotësue të gjitha. Do të shprehi dhe do të uroj punë të mbarë, do të përgëzoj për këtë punën të cilën e paske bërë para fillimit të vitit shkollor. Por, në bazë të informacioneve që unë po posedoj nëpër shkolla, akoma materialet harxhuese nuk i kemi shpërndarë. Kështu që shkollat, që nga fillimi, nga starti do të kenë probleme me materiale harxhuese, pikërisht letër dhe pajisje higjienike. Pasi që veç fillimi dihet, kërkohet më shumë letër, pasi që kemi kopje të shumta, të nxënësëve, bartjet e tyre etj. Por, para së gjithash unë do të përgëzoj për punët të cilat thaje se i kemi kryer. Ishalla nuk vjen koha që në momentet të them nuk është e vërtetë. Ndoshta në të kaluarën më ke marrë pak inati, se veç kam akuzue, po kam akuzue me të drejtë. Dhe, ashtu si i tillë, kur është me të lavdërue, të lavdëroj prapë kur është puna për me të lavdërue. I kam dy pyetje të cilat jo zyrtarisht kam dëgjuar. A keni informacion se, sipas disa të dhënave, në fshatin Pllajnik nuk kemi asnjë nxënës fillorist. Unë kam dëgjuar kështu dhe, nëse është e tillë, çfarë do të ndodhë me atë shkollë dhe me mësime të cilët punojnë në ato shkolla. E njëjta pyetje bartet edhe për shkollat tjera të cilat kanë mungesë – nuk është problemi i juaj, por është problemi i migrimit të nxënësve të cilët lëvizin, qoftë në botën e jashtme, qoftë nëpër qytete tjera të Kosovës. Dhe e dyta, nga këto lëvizje të nxënësve, numri i rënies gradualisht që po ndodh në këtë periudhë vjeçare 2023/2024, dhe fillimi 2024/2025 – për këtë vit kalendarik flas – në bazë të atyre të cilët ju keni nxjerrë deri më tani, për shkak të mungesës së fondeve, të normës së orëve, dhe për shkak të zvogëlimit të klasëve, sa kolegë apo kolege kanë mbetur pa punë dhe çfarë do të ndodhë në të ardhmen me ta. Faleminderit!

**Artan Loshaj:** z.Drejtor, rreth arsimit ne e kemi profën këtu, po veç një pyetje. Prita me e bo nga profi, por nuk u bo. Ju thatë që ditën e hënë, më 2 shtator fillon mësimi, ndërsa më herët thatë që nuk ka kontratë për transportin e nxënësve. Sot është dita e fundit për me bo kontratë, ditën e hënë fillon mësimi. Kur do të nënshkruhet kontrata edhe, pas nënshkrimit të kontratës, sa ditë duhet të priten ankesat e kompanive tjera edhe si do të fillojë mësimi, a do të fillojë mësimi edhe kush do ta bëjë transportin e tyre, derisa të bëhet kontrata e kompanive. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Të nderuar delegatë, meqenëse po mungon z.Selaj, unë deshta ta falënderoj për propozimin e kësaj pike mjaft të qëllume, që ju realisht vetë u dasht me e fut në rend të ditës. E falënderoj edhe dektorin e DKA-së, i cili informoi aq sa ishte i informuar dhe i përgatitur. Po ndrlidhem me një çështje që më është shfaq personalisht mu dhe goxha më ka pëlqye. E di që numri i nxënësve po bie, e kolektivi po minimizohet. Këtë e kam pas të njohur nga ish-drejtor Selim Kryeziu, ku në këtë foltore pat cituar se rreth 105 norma janë mangu në Dragash. I bjer që 105 mësues nga 550 euro rrogë mesatare, goxha dëm mujor ne i bëjmë Ministrisë së Arsimit dhe vetë shtetit. Qysh i keni sistemue qata 105 mësues pa norma. Jam kërcëue edhe nga ish-drejtori i DKA-së se s'ka orë për shoqen teme. Të nderuar qytetarë, nusja jeme është arsimtare e Gjuhës angleze, punon në ShFMU "Ilmi Bahtijari" në paralelet e ndara Blaç, Zaplluxhe edhe Zgatar. U pranue në punë në vitin 2011, me 20 orë të plota në paralelet e ndara në ciklin e ulët. Tash më në fund, ekzekutivi e paska gjet një mundësi për me më kërcënue që unë me hesht, duke ia larguar normën bashkëshortes sime. Kjo është hipokrizi, e nderumja kryesuese. Pata qef me qenë këtu edhe përfaqësuesja për barazi gjinore. Meqenëse e kemi OSBE-ne, besoj që ata kanë me ndikue, pres ndikimin edhe tëndin, znj.kryesuese. Goxha do takim i keni mbajt për barazi gjinore. Në fshatin Blaç janë tre mësimdhënës të gjuhës angleze, dy janë në ciklin e lartë, ndërsa bashkëshortja ime i përket ciklit të ulët. Prej ciklit të lartë, sipas gojëdhënave që kam, drejtori i shkollës jau ka ndarë nga tetë orë, përveç atyre iu ka dhënë edhe lëndë zgjedhore që me jau plotësue normën. Orët janë ndarë në mënyrë jo të drejtë, për shembull te profesorët e gjuhës shqipe orët janë ndarë te tre profesorët nga 19 orë. Nuk janë bë dy profesorëve nga 20 edhe të tretit me i mbet 18, por është ndarë në mënyrë profesionale, gjë që më ka pëlqye kjo, se është barazia. Ndërsa, te rasti i bashkëshortes sime, i janë plotësuar dy profesorëve të mëhershëm, edhe bashkëshortja jem ka mbet me ato orë sa janë. Nëse s'ka orë, unë kam qef me ia hek edhe krejt, se s'ka. Por prej 105, që janë përmend në këtë foltore dhe ekziston, dëshmi është, se ne i kemi mediat këtu që i përcjellin, prej 105 mësuesve që janë pa norma, ju vazhdoni me rekrutue mësues tjerë, njerëz të juaj – e dini ju qysh i rekrutoni ata – e në këtë rast prej të parëve që është largue është e gjinisë femërore edhe – nashta aksidentalisht po mu s'po më besohet - në këtë rast është bashkëshortja jeme. Ka kontaktuar me dektorin e DKA-së, më herët në fillim, dy herë kur e kam thirrë në telefon më ka thënë s'jam i njoftuar po e rregullojmë këtë çështje. Kur e ka marrë vesh qysh është puna mo s'un po e rregullon atë çështje. Mirëpo, asnjë njoftim zyrtar nuk e ka dërgue. Largohen orët, ky është orari, të pëlqen ose jo, pa asnjë njoftim zyrtar. Unë jam mundue me diskutue në mënyrë shoqërore dhe njerëzore, me e gjet një zgjidhje, por deri tash nuk më kanë ofrue zgjidhje. Patjetër që kam me i ndjek rrugët ligjore, do të bëj kërkesa. Nëse ju mendoni që me më ndalë mu me e ngrit zërin karshi hajnisë dhe keqpërdorimeve që bëhen këtu, duke më kërcënuar edhe më prek në anëtarë të familjes, këtë kurrë në jetë nuk keni me e pas këtë favor. Largoni orët, por shoqja jeme le të jetë ka 50-shi diku, jo bash e para, as e fundit mos të jetë. Unë jam pro të vërtetës edhe realitetit. Ama nuk mundesh me më kërcënue mu t'u ia hek orët asaj. Hiqni orë sa të doni, po unë jam këtu. Nuk iki! E pres një reagim të zonjës Piraj, e cila i përket Departamentit të Barazisë Gjinore, e bashkë me të edhe zonjës Kryesuese. Kolege të nderuara, keni mbajt disa takime, e keni mbrojt gjininë femërore, mirë është me u solidarizue nëse e shihni të arsyeshme. Nëse jo, le të shkojë qysh të shkojë. Faleminderit shumë!

**Arijeta Skeraj:** Kolegu Uran m'u drejtua që bashkëshortja e tij paska pas disa pakënaqësi ose ia kanë bërë të padrejtë. Sa për informatë, ti e di Uran që Zyra për Barazi Gjinore edhe ajo duhet, në qoftë se e shohish ti që ia kanë bërë të padrejtë, ajo pasi është arsimtare duhet vetë me ardhë në Komunë. Po ashtu edhe unë e kam zyrën ku mund me ardhë. Siç e dish, Uran, ne e kemi edhe grupin joformal të grave që e kemi edhe kryetaren. Në qoftë se ka padrejtësi, por këto kompetenca i ka drejtori i Arsimit, por nëse ia ka bo siç thaje ti të padrejtë, atëherë zyrja ime është e hapur. Kurdo le të vjen dhe do i ftoj të gjitha asambleistet, në qoftë se ne e shohim që ia kanë bo të padrejtë, atëherë edhe ne do të merremi me DKA-në. Në DKA ne nuk guxojmë me hi, sepse secila drejtori i ka punët e veta, por në qoftë se ti e ke parë që ajo është e shkelur – unë jam edhe anëtare e Lobit për Barazi Gjinore drejtpërdrejt në qendër, kështu që direkt më bjer mu. Kështu që, e pres bashkëshorten tuaj, por edhe në emër të zyrtares për Barazi Gjinore, e ftoj që ajo le të vjen dhe të shohim se çka është këtu puna, dhe besoj që do ta përkrahim.

Faleminderit!

**Agron Gashi:** Meqenëse kolaga Uran u ankua lidhur me padrejtësitë që ndodhin në punën arsimore, nga përvoja e punës 25-vjeçare, ajo që kam parë, është qenësore. Shoqja juaj është punësuar nga viti 2011 dhe të tjerët janë punësuar pas saj, në shkollat tjera zbatohet që të moshuarit që kanë pas të drejtën për plotësim të normës dhe pastaj këta që kanë ardhur më vonë. Me reformat e reja parashihen edhe performanca e punës. Jep rekomandime drejtori i shkollës që mund t'i jep përparësi edhe të punësuarit pas shoqes suaj, mirëpo e tëra është që një herë janë respektuar ata sipas punësimeve. Kur është e njëjta përgatitje profesionale, atëherë më të moshuarit një herë i takon. Mirë që e paraqite në Asamble si lloj shkelje, këto probleme duhet të gresh rregulloret, është Inspektoriati në regjionin e Prizrenit, kërkesat tuaja duhet të adresohen të formuluar. Neve mund të japim rekomandime, mirëpo mbi të gjitha MASHTI ka inspektoriatin regjional i cili merr pjesë edhe në Komunën tonë dhe atje janë kompetentët të cilët duhet t'i zgjidhin këto probleme. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, i nderum z.Gashi! Pyetjet nuk t'i kam parashtrur ty, po mirë që qite pa kripë aty në gjellë të huaj. Faleminderit edhe për "ndihmë". Drejtor, nëse mundesh me më kallxue mënyrën e ndarjeve të orës, ato që i përmendi z.Gashi. Përveç kësaj, po të ftoj që me më informue edhe në mënyrë zyrtare për këto pyetjet që unë t'i kam bo. Cila është mënyra e ndarjes së orëve, kush e bën ndarjen e orëve, drejtori në Blaç më ka thënë që kanë ardhë prej Dragashit qeshtu. Drejtori i DKA-së thotë që ne nuk i ndajmë orët, kolegjaliteti bashkë e bën marrëveshjen e ndarjes së orëve. Sa i përket edukimit, i nderum Gashi, provimet e magjistraturës shoqja jeme i ka të kryme, ndërsa kolegët e saj janë me dy vjet shkollë të lartë, mandej e dish ju qysh e keni rregullue atë çështjen, me ka ja 2-3 provime dhe keni ardhë në atë nivel. Plus është me 240 kredi të lëmisë së edukimit, a po më kupton? Këtë pjesë e kam të zgjidhur, rrugën ligjore e di shumë mirë, ama mu po më vyn që këtë rrugë me ma çelë këta në mënyrë zyrtare. Unë patjetër që kam me i ndjek rrugët ligjore. Faleminderit shumë për solidaritetin, znj. Kryesuese, do të diskutojmë edhe për këtë çështje, po besoj që vjen personi në fjalë vetë! Faleminderit shumë!

**Zeni Krasniqi:** Mu po më vjen mirë që ish-kolega – sepse unë e kam ndier veten shumë të ofenduar nga takimi i kaluara – tash a po e sheh që kaloi një muaj ditë edhe tash po rrëqethem. Kam punuar me të, për fat të mirë, edhe unë ndihem shumë krenar që kam pas rastin në atë tempull të punoj, me një përvojë mbi 18 vite punë në "Ruzhdi Berisha". Po sot më falënderoi ky. Driton, thaje sa është ndryshimi i nxënësve të regjistruar prej vitit të kaluar në klasën e dhjetë. Unë nuk e di a nuk ishe këtu, të thashë se informata zyrtare nuk kam, nuk e kam marrë ende emailin zyrtar të vulosur prej drejtorit të Gjinnazit, po janë përafërsisht aty 130. Është e vërtetë ti që thaje 80, mirëpo kanë qenë ata që i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret. Kanë qenë edhe disa tjerë që dokumentacionin drejtori i shkollës e ka ndarë dhe ka ardhë te unë, bashkë me të jemi marrë vesh që të plotësohen dy drejtimet që i kemi paraparë, shkencor-natyror dhe drejtimet e farmacisë. Nuk është e vërtetë që s'ka pas konkurs, ka qenë konkursi, tash komisioni ka punue, e ka bërë regjistrimin, edhe në farmaci. 9 nxënës i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret. Me kohë e kam përgatit dokumentacionin, e kam dorëzuar në Zyrën e Prokurimit. Pse ata kanë pas një volum shumë të madh të punëve, edhe pse neve nuk na ka ardhë radha, mirëpo planifikimi është bërë me kohë. Ka mundësi në shkollën e re, edhe drjetori u zotue se mësimi në Bresanë do të fillojë, unë të thashë. Në Bresanë mësimi fillon me 2 shtator, me ndërrime, derisa të kryhen punimet. Punëtorët janë zotuar se që të bëhet puna mirë dhe si duhet, këtu duhet 20 ditë. Ata kanë fillue para disa dite. Ju lutem, ky është objekt ku fëmijët duhet me fillue me mësim, prandaj kam kërkuar që të punojnë me një dinamikë të shtuar, që më 2 shtator ta kemi shkollën gati. Del komunikata zyrtare prej Ministrisë se më 2 shtator do të fillojë viti shkollor. Unë të thashë që e kemi një drejtor atje që i ka bërë përgatitjet dhe ai e dha fjalën, edhe unë isha atje dhe e pashë gjendjen si është. Unë nuk e di sa isha i kjartë, janë shpërndarë, na i kanë dorëzue katalogët me kohë. Unë si drejtor i DKA-së kam shpërndarë nëpër shkolla katalogjet. Edhe aktivët – ti e di çka janë aktivët - mbliidhen dhe ata përcaktohen për cilët libra dhe shpi botuese. Tash, a ka interes a çka ka atje, mu nuk më intereson, te preferencat s'mundi me hy se s'kam informata, por me i hetue do të kenë punë me mu. Driton, kjo punë ka përfundue, listat kanë dalë nëpër shkolla, ata prindër që nuk dinë të orientohen do të shkojnë, e shohin se cilat libra iu duhen. Për uebfaqet

e shkollave, ato shkolla që i kanë gjithçka qesin aty dhe bëjnë informata për gjithçka që ndodh në shkollë. Disa drejtorë më njoftojnë. Nexha po thotë kam informacione, materiale hargjuese mungojnë, gjegjësisht letra dhe material hargjues. Ne e dimë se qysh herët jemi furnizue me material hargjues dhe unë e di që shkollat nuk kanë pas problem. Unë e di që një herë ka ardhë sekretari i shkollës – nuk kemi – i thashë a ke shkie naltë në depo me e pyet atë depoistin, tha jo. Janë të furnizuara, megjithëse shkollat dhe drejtorët e dinë shumë mirë. Për gjithçka që keni nevojë, urdhëroni drejtohuni te depoisti këtu. Nuk mungon materiali, vetëm nëse drejtorët nuk janë në nivel të detyrë. Jozyrtarisht thaje në Pllajnik, nuk kemi informata se s'ka, po unë po them këtu publikisht se sivjet që nuk kemi nxënës në klasë të parë janë: Shkolla fillore, paralelja e ndarë në Buqe, dhe në Rrenc. Për Pllajnik bëri, por në Pllajnik ka. Nuk ka kërkesë prej drejtorit, unë këto duhet t'i paraqes me kohë. Kemi bërë zgjidhje për të dy këta arsimtarët, kemi edhe urdhër prej Ministrisë që të mos largohet asnjë arsimtar. Deri tash kështu kanë veprue edhe mirë kanë veprue. Do ta lidh këtë bisedën me përgjigjen që do t'i jap Uranit, lidhur me këtë trend, se nuk dihet – mësuesi klasor i fshatit Buqe po thotë kurrë s'e kam ditë që ka me ardhë kjo kohë që unë do të mbetem pa punë pas kaq vitesh përvojë pune, pa nxënës. Këtu e more përgjigjen se sa mësimdhënës kanë mbet pa punë, këta dy kanë qenë, këta i kemi rregullue dhe gjithçka është në rregull. Ne si DKA e kemi dërgue dhe për fat të mirë që ka dalë tenderi me kohë, kemi disa ofertues, është bërë hapja edhe dihet se cili cilat linja i ka të transportit të nxënësve. E tash, unë po them që zyrtarisht më 2 shtator jemi të gatshëm edhe i kemi bërë përgatitjet që të fillojë mësimi. Si do ta bëjë ai transportin e nxënësve është çështja e tij, e operatorit. Nëse jo, unë sa kam informata prej Zyrës së prokurimit, se të martën ose të mërkurën nënshkruhet kontrata. A është i gatshëm ai që ta kryejë detyrën, atëherë ne jemi aty dhe do t'i përcjellim për çdo parregullsi. Ai e ka marrë këtë përgjegjësi, e ka fitue tenderine dhe duhet të bëjë transportin e nxënësve. Ne kërkojmë që nxënësit më 2 shtator me qenë para shkollës. Uran, ti thaje që jem godit edhe drejtpërdrejt personalisht. Ne i kemi pas dy biseda, një në telefon, një edhe kështu, ishe dje në zyrë. Mu më erdhi shumë keq që e përmende një fjalë, thaje hipokrizi. Prej meje nuk e di që ke marrë kërcënim. Nëse unë të jam kërcënue, urdhëro del këtu edhe trego. Unë dje e pata drejtorin, ai tha që as një takim nuk e kam pas me to. Me ty. Ndarjen e normave, mbliidhen aktivët e shkollave, e shohin sa është fondi i orëve, kanë edhe kryetar këto aktivët profesionale. Është një rregull, mirëpo nuk është e shkruar, që më i vjetri gjithmonë ka përparësi në plotësimin e normës. Nuk i kemi bo të padrejtë bashkëshortes tënde. Ka mbet shoqja me 14 orë gjuhë angleze, mirëpo tash nëse ajo ka mbet pa orë, unë të thashë se si duhet të veprojë. Duhet të bëjë kërkesë në drejtorinë e shkollës që të plotësohet norma. Nëse drejtori i shkollës nuk merr masa, atëherë i drejtohesh DKA-së edhe ne bëjmë zgjidhje. Unë jam që të respektohet gjinia, por a i bjer me ardhë në Llopushnik, a në Dragash, a në Pllajnik, tash nuk e di. Ajo pa normë nuk ka me mbet. Ti rrugët tjera urdhëro, ndiqi. Nuk ta merr atë të drejtë kërkush, mirëpo padrejtësi nuk ka, hipokrizi nuk ka. Faleminderit!

**Nexhat Selaj:** z.Drejtor, jo rastësisht e ka thënë, dhe gjithashtu sa të është e rrugës do ta them. Mos e kupto në atë fjalën bukfalet, i paditur, po i paditur për çështjen dhe pozicionin se ku e ke. Jo i paditur në fusha të ndryshme, po i paditur për punën të cilën je i caktuar. Kështu që, duhesh ta ndajsh, i paditur në aspektin e përgjithshëm, edhe i paditur për punën të cilën je duke e bërë. Edhe ne asambleistët, edhe ju vetë personalisht e dini se kjo është hera e parë që dalish në mënyrë transparente dhe në mënyrë të përgatitur që na japish sqarime për të gjitha ato që ne i kërkojmë. Mu po më vjen shumë mirë që je përgatitur dhe na ke sjellë të dhëna meritore për fillimin e këtij viti shkollor. Nëse ajo e para ka qenë ofenduese, kjo nuk po të them se është lavdëruese, po kjo është ajo e cila ju takon juve si drejtor me e thënë. A thua unë e kam ndier veten të fyer, kur katër herë radhazi, katër seanca njëra pas tjetër kam bërë pyetje dhe ju keni folë me kryetarin, edhe pa më dhënë përgjigje dalë jashtë. A nuk është edhe kjo fyerje?! Ato kanë qenë të gjitha për të cilat ju nuk keni pasur njohuri për këtë fushë të cilën ju e zhvilloni. Edhe ti shumë mirë e din, unë nuk po due me hi më tepër, mirë u bo këto që t'i thashë që të bindet edhe kolega yt – Samidini – se e paska mundue edhe këtë fjala “i paditur”. Kjo ishte vetëm në aspektin e fushës të fushës të cilën e zhvillon. A në aspektin kolegial, unë jam konë gjithmonë kolegë edhe shembullorë, të cilët kemi punuar 7-8 vite bashkë, edhe aty unë nuk mundem me e ditë sa di, se ky

është ekonomist, unë jam gjeograf. Nuk mund t'i jap shënimet edhe nuk mund ta di sa i din. Por në aspektin kolegjial gjithmonë e kam çmue dhe do ta çmojë si kolegë. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Drejtor, absolutisht, personalisht për ty nuk thashë hipokrit ose që po më kërcënojs. Po keqkuptosh edhe po i marrish shumë personale gjërat, bonu pak më politikan. Unë jam ndier i kërcënuar, jo nga ti personalisht, nga ekzekutivi, nga politika, se unë gjithmonë jam konë i kërcënuar prej politikës, vazhdimisht, se këta 10 vjet s'më kanë marrë në punë. Me shoqen time kam qenë me një klasë edhe me një bankë, ajo i ka 12 vjet përvojë pune, unë e kam një zëvendësim ose dy me ka ja 6-7 muaj, s'e kam atë problem. Unë i kërcënuar prej politikës kam qenë vazhdimisht, jam i kalitur në këtë drejtim. Mos e merr pesonale, po folim kërcënim është që ty të mohohet një e drejtë. Nuk jam dorëzue ndonjëherë, nja 10 vjet këndeje, edhe këndeje sa keni edhe disa muaj, hiç s'e marr si kërcënim. Vazhdomi ju me të juajën, mirëpo ajo që më mbet hatri prej një drejtori të arsimit – se masnej po ankohesh që po të thotë i padijshëm ose nuk po i lidh dy fjalë – nuk munden me pas në legjislaturë, ku ne institucioni i shkollës, me e bo një rregull të pashkruar. Nuk funksionon një çështje e rëndësishme me rregulla të pashkruara, i nderum drejtor. Për herë të parë unë kam dëgue se ekziston një rregull i pashkruar. Qysh do me thënë unë munda me bo çka të due, kur të vjen puna te gjykata, he çka u bo, sipas rregullit të pashkruar. Mos bëni këso përgjigje qesharake!

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit! Atëherë fillojmë te pika për formimin e Komisionit hetimor për mirëmbajtjen e veturave zyrtare, që e ka kërkuar z.Uran Halimi. Kërkoj një emër nga PDK, që është partia më e madhe!

**Shpetim Hajredini:** S'besoj që paraqet ndonjë problem që ta propozoj veten në këtë Komision!

**Anesa Mehmeti:** Në emër të LDK-së propozoj z.Gazmend Ramadanin.

**Uran Halimi:** Propozoj veten nga radhët e VV-së!

**Agron Gashi:** Atëherë, meqenëse iu dha e drejta të tjerëve për vetëpropozim, edhe unë po e propozoj veten time!

**Munir Jonuzi:** Në emër të Koalicionit Vakati propozoj veten.

**Ventaza Esati:** Përshëndetje të gjithëve, nga JGP propozoj Edin Kurt.

**Nedžmidin Sejdilar:** Ne nga Lëvizja për Goren nuk kemi askënd përveç meje. Do të jem i lumtur t'i hetoj ato pretendime të Uranit.

**Merhunisa Brenoli:** Përshëndetje të gjithëve, propozoj Miralem Rahtën për anëtare të komisionit

**Bexhet Xheladini:** Nga ekzekutivi propozoj Kerim Latifin

**Munir Jonuzi:** Të gjithë kemi propozuar në emër të subjektit politik që kemi përfaqësuar për zgjedhjet e vitit 2021, kolegia ime ka qenë në atë listë, tani nuk është, nuk e di se në çfarë cilësie po propozojnë një kandidat tjetër. Unë përfaqësoj koalicionin Vakati në këtë kuvend. Unë bëra një sugjerim për të nominuar veten. Kolege nga cili subjekt politik, i panjohur për ne, e ka sugjeruar këtë listë, nuk e di. Ne nuk mund të propozojmë këtu vetëm sepse duam. Kryetari sugjeroi dikë nga pushteti ekzekutiv dhe kolegu Miralem nuk përfaqëson pushtetin ekzekutiv, por legjislativin. Kemi 7 anëtarë, pa llogaritur këtë propozim fantazmë dhe 8 nga Kryetari. Unë ju kërkoj Kryesuese të veproni sipas atij dokumenti, i cili është i vetmi autoritativ dhe i verifikuar nga KQZ.

**Nedžmidin Sejdilar:** Pak më parë morëm vendimin për formimin e një komisioni parlamentar. Që Kuvendi të formojë një komision që do të shqyrtojë se si i ka shpenzuar pushteti ekzekutiv te hollat. Anëtar i këtij komisioni nuk mund të jetë person nga pushteti ekzekutiv. Nuk mund të vendosim dikë nga pushteti ekzekutiv dhe tani do ta marrim në pyetje. Është një konflikt interesi. Çfarë komisioni me 8 anëtarë. Komisioni duhet të marrë një vendim disi. E vëmë në dyshim pushtetin ekzekutiv. Dhe e treta, Vakati nuk mund të ketë 2 anëtarë në komision. Se kartat u ngatërruan. Disa delegatë kaluan në një opion tjetër politik. Ata janë në KQZ me emrin me të cilin kanë marrë pjesë në zgjedhje. Aktualisht Vakati ka 3 delegatë, dhe nuk mund të ketë 2 anëtarë në komision. Ky është një formim i gabuar i komisionit. Ju lutem, le ta zgjidhim këtë në një mënyrë adekuate.

**Arijeta Skeraj:** Atëherë, para se me ia dhënë Miralemit fjalën, Sejdilar, ishe këtu në Kuvend. Lypa prej PDK-së, m'u dha emri, lypa prej LDK-së m'u dha emri, lypa prej VAKAT-it, m'u dha emri. Merhunisa Brenoli e kërkoi fjalën, tash unë e pyes zyrtarin ligjor dhe do ta sqaroj këtë punë a i takon a



jo. Pasi këtu në listën e delegatëve, këtu shkruan tre vetë prej VAKAT-it janë. Unë nuk do të bëj shkelje assesi, pa marrë parasysh kush e tek. Edhe për ekzekutivin do ta pyes zyrtarin ligjor, se unë sa e do çdo komision ka pas prej ekzekutivit.

**Miralem Rahte:** Ne, në marrëveshje me Merhunisin, meqë jemi ende të regjistruar në Vakate, dhe kaq, morëm vendim në marrëveshje që unë të jem anëtar i komisionit. Në emër, si jemi atje. Dy prej nesh, nga tre anëtarë, vendosëm që unë të jem anëtar.

**Arijeta Skeraj:** Miralem, ti e propozove veten prej partisë VAKAT. Ju jeni VAKAT, se këtu po më shkruan VAKAT. Tre anëtarë janë nga VAKAT-i, ju jeni në emër të VAKAT-it. Ti po e propozon veten tënde, Muniri e propozoi vetveten. Atëherë, mu më duhet një sqarim me zyrtarin ligjor dhe pas pak do të jap përfundimtarën se kush do të jetë në Komision.

Atëherë, pas sqarimit me zyrtarin ligjor, në bazë të propozimeve që u dhanë nga partitë, unë kam kërkuar nga VAKAT-i dhe Munir Jonuzi e ka marrë i pari fjalën, kështu që, ose le ta bëjnë këta tre një diskutim, tash pesë minuta, dhe le ta bien një person, ose i pari që e ka marrë fjalën, ai do të shkojë.

**Munir Jonuzi:** Tani ke filluar te me nervozosh edhe mua se ke filluar te besh standarde te dyfishta. A e bëni këtë vetëm kur bëhet fjalë për komunitetin joshumicë apo mbi të gjithë. Kolegu Shpëtim është kryetar i grupit të tyre parlamentar, doli në foltore dhe u prezantua, sepse ka të drejtë të flasë para subjektit të tyre politik. Uran Halimi, është kryetar i VV-së, ka propozuar vetë. Jetmiri nuk është këtu, ndaj Urani e ka marrë atë rol, në emër të Vakait vetëm unë mund të sugjeroj. Kjo është marre, të bëjmë cirk nga ky kuvend. Njerëzit shkuan në një listë tjetër, dhe ata do të flasin në emër të Vakait, kjo nuk është e drejtë. Nuk është e drejtë që ju si kryesuese të veproni në atë mënyrë. Ne nuk duhet të bëjmë disa lëshime dhe të zbatojmë veprime të kundërligjshme në kuvend.

**Miralem Rahte** –Nuk e di kush e ka zgjedhur kë të jetë kryetar i grupit parlamentar. Nuk e di as kur e kemi zgjedhur kreun e grupit nga ndonjë parti politike. Ky nuk është parlamenti në Prishtinë, kështu që ta zgjedhim kreun e grupit. Ne jemi 3 anëtarë në letër, 2 anëtarë duan që unë të jem, unë vetëm kërkoj që të jetë e ligjshme.

Munir Jonuzi – Është e qartë se Miralem Rahte e ka harruar asamblenë e parë, kur kemi dorëzuar përfaqësuesit e secilit subjekt. A ju kujtohet kur u morëm vesh për ekskursionin, nuk deshe ta pranoni Miralemin në marrëveshjet e subjekteve politike, sepse subjekti i tij aktual politik nuk ekziston në këtë kuvend, tani befaz ndërro mendje. Më jepni sipas ligjit që është e drejtë. Këta që u larguan nga Koalicioni Vakate nuk ishin në komisionin që ju zgjodhi kryesuese. Këtu në këtë kuvend kam përfaqësuar dhe drejtuar Koalicionin Vakate, jo vetëm këtu, por edhe para zgjedhjeve dhe në kuvend.

Nedzmidin Sejdlar – Për mendimin tim, ky është një diskutim i kotë dhe një humbje kohe. Nëse mund të mbaroj. Ata vetë zgjodhën Jonuzin për t'i përfaqësuar, nga ana tjetër u larguan nga partia e tij. Nëse futemi në detaje, në komisionin e pagave zonja Merhunisa merr rrogë në emër të Kadri. Si e bëri ajo. Adem Emini është dëshmitar. Ka shumë sende pa logjikë në këtë kuvend. Nuk mbarova. Qetësoje atë. Për të shkurtuar këtë agoni. Më intereson sa anëtarë do të ketë ky komision. Sa më shumë të ndahen, aq më mirë do të jetë për ne njerëzit. Vakate nuk mund të ketë 2 anëtarë. A keni marrë përgjigje nga zyrtari ligjor nëse autoriteti ekzekutiv ka të drejtë të ketë një anëtar në këtë komision.

**Arijeta Skeraj** – Duke pas parasysh që nuk kemi kворum për vazhdimin e seances, me kete e mbylle seancen e sotme te Kuvendit. Ju faleminderit.

Kryesuesja e Kuvendit  
Arijeta Skeraj